



## **Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit**

### **Programi i studimit: Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe**

*Niveli i studimeve:*  
MA Profesional

*Numri i kredive:*  
60 ECTS

*Akredituar për periudhën:*  
1 Tetor 2016- 30 Shtator 2019

*Hartimi i këtyre materialeve është bërë me ndihmën e projektit "Modernizimi i Shkollimit të Mësimdhënësve në Universitetin e Prishtinës, nr. 544023" financuar nga Bashkimi European.*

*The European Commission support for the production of this publication does not constitute an endorsement of the contents which reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.*

## **PËRMBAJTJA:**

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT .....	4
2. REZULTATET E PRITURA: .....	5
3. PASQYRE E PROGRAMIT: Mësimdhënie në gjuhë dhe letërsi shqipe .....	6
4.1 PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS (GRUPI A) .....	8
4.2. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS (GRUPI B).....	16

## 1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i përgjithshëm i programeve master në mësimdhënie lëndore është që të avancojë më tutje kompetencat moderne të mësimdhënies dhe të praktikës pedagogjike, krahas atyre akademike, duke marrë për bazë edukimin paraprak dhe nevojat e secilit profil të mësimdhënies lëndore.

Qëllimet specifike të secilit program janë:

- Avancimi i kompetencave moderne të mësimdhënies së Gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe të praktikës pedagogjike për kandidatët, që vijnë nga programet arsimore të fakulteteve akademike, me përgatitje adekuate akademike.
- Avancimi i kompetencave akademike për kandidatët e këtij programi, që vijnë nga Fakulteti i Edukimit, ku kompetencat e mësimdhënies janë të mjaftueshme, ndërsa nevojitet të plotësohen më tutje komponentët akademikë.

### **Grupi target që i dedikohet programi:**

Grupi target që i dedikohet ky program është i ndarë në dy nëngrupe:

**Nënprogrami A** - Kandidatët që kanë përfunduar studimet baçelor në Fakultetin e Edukimit (240 ECTS) dhe

**Nënprogrami B** - Kandidatët që kanë përfunduar studimet baçelor në fakultete të tjera arsimore (240 ECTS) dhe kanë pasur të paktën 20 ECTS të kurseve nga fusha e didaktikës.

## **2. REZULTATET E PRITURA:**

Me përfundimin e suksesshëm të programit të studimeve, studentët do të jenë në gjendje:

- Të zbërthejnë kurrikulën dhe rezultatet e dëshiruara në përmbajtje dhe aktivitete të logjikshme e të kuptimshme për nxënësit.
- Të zbatojnë strategji të ndryshme të mësimdhënies, të të nxënit dhe të vlerësimit, si dhe qasje pedagogjike adekuate, duke ua përshtatur aktivitetet nevojave dhe interesave të individëve dhe të grupeve të nxënësve.
- Të bëjnë hulumtime me bazë në shkollë/klasë, me qëllim të sigurimit të informacionit për përmirësimin e rezultateve të të nxënit dhe sigurimit të mjedisit të përshtatshëm për të gjithë nxënësit.
- Të shfrytëzojnë teknologjinë mësimore si mjet për ndërtimin, zbatimin dhe komunikimin e njohurisë dhe informacionit.
- Të demonstrojnë aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive me nxënësit, prindërit, kolegët dhe komunitetin, në funksion të mirëqenies së të gjithë nxënësve.
- Të zbatojnë legjislacionin arsimor dhe politikat arsimore, që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e mësimdhënësit.
- Të demonstrojnë të kuptuar të thellë të fushës akademike dhe shkathhtësi të avancuara për t'i zhvilluar konceptet kryesore në klasë.
- Të zhvillojnë shkathhtësi të avancuara të leximit e të shprehurit, si dhe të nxisin kreativitetin tek nxënësit.
- Të shfrytëzojnë burime të informacionit shtesë nga fusha e gjuhës dhe letërsisë në funksion të avancimit akademik dhe të mësimdhënies.
- Të shfrytëzojnë kompetencën e tyre gjuhësore dhe letrare, për të krijuar ndërlidhje me fushat e tjera lëndore.

### 3. PASQYRE E PROGRAMIT: Mësimdhënie në gjuhë dhe letërsi shqipe

**Grupi A** - Kandidatët që kanë përfunduar studimet baçelor në Fakultetin e Edukimit  
(240 ECTS)

#### VITI I

##### SEMESTRI I

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Mësimdhënia efektive	O	3	5
2.	Mësimdhënia e avancuar nga gjuha	O	3	5
3.	Metodologji e leximit letrar	O	3	5
4.	Romani shqiptar	O	3	5
5.	1. Komunikimi ndërveprues 2. Historia e albanologjisë së shekullit XX	Z	3	5
6.	1. Analizë e tekstit letrar 2. Komenti letrar	Z	3	5
<b>Gjithsej</b>			<b>18</b>	<b>30</b>

##### SEMESTRI II.

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Metodat e hulumtimit në edukim	O	3	4
2.	1. Praktika bashkëkohore në edukimin inkluziv 2. Menaxhimi i klasës 3. Komunikimi në arsim 4. Menaxhimi i arsimit dhe politikat arsimore	Z	3	4
3.	1. Sistemi emëror dhe foljor i shqipes 2. Gramatikë e zbatuar 3. Autorë të zgjedhur të letërsisë	Z	3	4
4.	Tipologjia e letërsisë shqipe	Z	3	4
5.	Praktikë e mësimdhënies	O		4
6.	Punimi i tezës	O		10
<b>Gjithsej</b>			<b>12</b>	<b>30</b>

**Grupi B** - Kandidatët që kanë përfunduar studimet baçelor në fakultete të tjera arsimore (240 ECTS) dhe kanë pasur të paktën 20 ECTS të kurseve nga fusha e didaktikës

**VITI I  
SEMESTRI I**

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Mësimdhënia efektive	O	3	5
2.	Psikologji e zbatuar në mësimdhënie	O	3	5
3.	Mësimdhënia e avancuar nga gjuha dhe letërsia	O	3	5
4.	Proza moderne shqipe	O	3	5
5.	1. Komunikimi ndërveprues (gjuhë, letërsi, kulturë, folklor, arte) 2. Kultura e komunikimit gjuhësor	Z	3	5
6.	1. Teoria e folklorit 2. Përkimet ndërmjet letërsisë gojore dhe asaj të shkruar	Z	3	5
<b>Gjithsej</b>			<b>18</b>	<b>30</b>

**SEMESTRI II**

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Metodat e hulumtimit në edukim	O	3	4
2.	1. Praktika bashkëkohore në edukimin inkluziv 2. Menaxhimi i klasës 3. Komunikimi në arsim 4. Menaxhimi i arsimit dhe politikat arsimore	Z	3	4
3.	1. Gramatikë e zbatuar 2. Zhvillimi i kurrikulës nga gjuha	Z	3	4
4.	1. Vlerësimi në gjuhë dhe letërsi shqipe 2. Zhvillimi i kurrikulës nga letërsia	Z	3	4
5.	Praktikë e mësimdhënies	O		4
6.	Punimi i tezës	O		10
<b>Gjithsej</b>			<b>12+P</b>	<b>30</b>

#### 4.1 PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS (GRUPI A)

Përshkrimi për secilin kurs (grupi A)	
1	<p>Mësimdhënia efektive</p> <p>Kursi përbëhet nga dy pjesë: pjesa e parë trajton aspektet e të nxënës dhe pjesa e dytë (që për nga vëllimi është më e madhe) trajton aspektet e mësimdhënies. Në këtë mënyrë, ofrohen njohuri të avancuara nga fusha e mësimnxënies dhe mësimdhënies. Në kuadër të këtij kursi ofrohen tema, që trajtojnë çështjet e strategjive të të nxënës, stileve të të nxënës, parimeve të mësimdhënies efektive, mënyrave të aplikimit të metodave efektive të mësimdhënies, e-mësimi (e-learning), taktin pedagogjik, rëndësinë e përgatitjes së mësimdhënësit, karakteristikat efektive të mësimdhënësit, etj. Lënda ofron mundësi të zhvillimit të shkathtësive për zbatim të suksesshëm të parimeve e strategjive të mësimdhënies, identifikimin e sfidave të mësimdhënies dhe dhënies, zbatimit të tyre për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p>
2	<p>Mësimdhënia e avancuar nga gjuha</p> <p>Objekt i këtij kursi janë metodat, modelet, teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies së gjuhës shqipe. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: përkufizimi i metodave të ndryshme në zhvillimin e të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit, njohuritë për sistemin gramatikor dhe drejtshkrimin, konceptet didaktike të të pyeturit, etj. Studentët do të bëhen hulumtues të veçorive psikologjike, didaktike dhe akademike të të shprehurit, të shkruarit dhe të lexuarit në fushë të mësimdhënies së gjuhës shqipe. Ata do të arrijnë të përmirësojnë praktikat e mësimdhënies dhe të nxënës.</p>
3	<p>Metodologji e leximit letrar</p> <p>Kursi <i>Metodologji e leximit letrar</i> përkufizon modelet e leximit të vëmendshëm dhe të kuptueshëm të krijimtarisë letrare-artistike, me qëllim që të nxirret struktura e teksteve letrare, që krijohen dhe perceptohen nga grupmoshat e nxënësve të shkollave fillore. Kjo lëndë përmban shumë faktorë dhe mënyra të shprehjes letrare në një tekst, që na detyrojnë të bëjmë kujdes në përcaktimin sa më të saktë të domethënies së tij, zbulimit të natyrës së fjalëve, interpretimit të tyre, kapjes së synimit të autorit, vokacionit, ritmit të prozës, vargut, strofës. Në programin fillor, si tekste bazë për lexim do të jetë krijimtaria popullore dhe e shkruar për fëmijë, nacionale dhe botërore, përmes librave të leximit dhe lekturës shkollore. Studentët të njihen me aspektet logjike, estetike dhe semantike të artit të të shkruarit dhe të lexuarit, të dëgjuarit dhe të kuptuarit e rrafsheve gjuhësore, letrare, përmbajtjesore dhe kuptimore të tekstit letrar.</p>



4

#### Romani shqiptar

Ky kurs ka për synim studimin e zhanrit të romanit në letërsinë shqipe, në mënyrë diakronike dhe sinkronike, pra edhe si prurje historiko-letrare, por edhe si formë e aplikuar, duke marrë shembuj të veçantë në shqyrtim. Romani shqiptar do të trajtohet edhe në kontekstin e shikimit të romanit si zhanër me karakter empiriko-historik, por edhe ideal –teorik (poetika e veprës). Në kuadër të këtij kursi do të kalohet në të gjithë opusin romanor shqiptar, ndërsa me ndihmesën teorike, do të analizohen tutje karakteristikat ideore-strukturore e kompozicionale, për të nxjerrë në pah vlerat artistike e estetike. Nëpërmjet shqyrtimit të stilit dhe forcës bindëse, narratorit të hapësirës së rrëfimit, kohës e kapërcimeve kohore, do të shqyrtohet mekanizmi i strukturës së romanit. Njëherësh, duke u marrë me disa nga autorët kryesorë të prozës dhe duke intensifikuar thellësinë e kërkimit tonë te këta autorë dhe këto vepra, do të synojmë arrijten e disa përfundimeve për romanin shqiptar, si një nga format e trashëgimisë sonë letrare.

5.1

#### Komunikimi ndërveprues

Objekt i këtij kursi janë mjetet e komunikimit në gjuhë, letërsi, kulturë, folklor dhe arte. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: mjetet dhe simbolika e komunikimit gjuhësor, letrar dhe artistik, komunikimi dhe informacioni, komunikimi me anë të gjuhës, letërsisë dhe arteve të tjera, gjuha në veprim, semantika e gjuhës, komunikimi me ndërveprim, komunikimi dhe shoqëria, komunikimi dhe interneti, etj. Studentët do të bëhen hulumtues të veçorive semiologjike dhe pragmatike, të performancës, të retorikës së komunikimit ndërpersonal, të konceptit ideologjik të komunikimit, të komunikimit masiv, të komunikimit përmes internetit. Ata do të arrijnë të përmirësojnë praktikën e komunikimit, duke i dhënë prioritet komunikimit gjuhësor.

5.2

#### Historia e albanologjisë së shekullit XX

Objekt i këtij kursi janë shkollat, domenet, nocionet, institucionet dhe personalitetet më të shquara të kësaj fushe të shekullit XX. Temat që përfshihen në këtë kurs janë albanologjia dhe fushat e saj si: gjuhësia, historia, etnologjia e folklori, historia e letërsisë dhe kultura materiale e shpirtërore shqiptare; dijet linguistike të kohës në Evropë dhe ndikimi i tyre në gjuhësinë shqiptare; institucionet kryesore albanologjike të shekullit XX; fushat kryesore të albanologjisë së shekullit XX; përfaqësuesit kryesorë të albanologjisë së shekullit XX; korpuset, përkatësisht, veprat më të rëndësishme të shekullit XX. Në këtë lëndë studentët do të arrijnë të krijojnë idenë për zhvillimin e albanologjisë në rrafshin nacional dhe ndërkombëtar

dhe konceptin për historinë e zhvillimit të saj.

## 6.1 Analizë e tekstit letrar

Kursi *Analizë e tekstit letrar* përkufizon modelet e leximit të vëmendshëm, përmbajtjesor dhe të kuptueshëm të krijimtarisë letrare-artistike. Në këtë lëndë studentët do të kenë mundësi të njihen me shumë faktorë dhe mënyra të shprehjes letrare të një teksti dhe të kenë kujdes në përcaktimin sa më të saktë të domethënies së tij, zbulimit të natyrës së fjalëve, interpretimit të tyre, kapjes së synimit të autorit, të artikulojnë intonacionin, ritmin, rimën, theksin, timbrin dhe tempin e leximit, si dhe anën logjike e emocionale të tekstit. Studentët do të njihen me aspektet logjike, estetike dhe semantike të artit të të shkruarit dhe të lexuarit, të dëgjuarit dhe të kuptuarit e rrafshëve gjuhësore, letrare, përmbajtjesore dhe kuptimore të tekstit letrar.

## 6.2 Komenti letrar

Kursi *Koment letrar* përbën një tërësi konceptesh e platformash hyrëse e paraqitëse teorike, që trajtohen sistematikisht në mënyrë më të zgjeruar në kursin e Teorisë së letërsisë. Përgjithësisht, kursi i përmbahet një strukture që zhvillon: koncepte mbi natyrën dhe mbi studimin e letërsisë, mbi analizën e veprës letrare, mbi poetikën tradicionale dhe ndikimin e saj mbi teorinë moderne të letërsisë, mbi konceptin e zhanreve dhe mbi tërësinë metodologjike të studimit të letërsisë dhe të tipizimit të saj.

## 7 Metodatat e hulumtimit në edukim

Ky kurs fokusohet në paradigmat, çështjet dhe metodatat e hulumtimeve në edukim. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: përkufizimi i metodave të ndryshme të hulumtimeve, analiza kritike e literaturës, grumbullimi i të dhënave sasiore dhe atyre cilësore nga mjediset e të nxënit, natyra dhe llojet themelore të hulumtimeve, të lexuarit kritik dhe interpretimi i hulumtimeve. Studentët do të bëhen “lexues kritikë”, në mënyrë që të analizojnë hulumtimet sasiore dhe cilësore në fushën e edukimit dhe të shfrytëzojnë rezultatet kërkimore në realizimin e hulumtimeve të tyre, për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të të nxënit.

## 7.1 Praktika bashkëkohore në edukimin inkluziv

Kursi ofron njohuri të avancuara nga fusha e edukimit inkluziv. Në këtë lëndë trajtohe tema, që kanë të bëjnë me përkufizimet bashkëkohore të inkluzionit, të drejtat e njeriut/fëmijës, filozofinë e edukimit inkluziv, format e inkluzionit në vendet evropiane, mundësitë e krijimit të një shkolle dhe shoqërie inkluzive, etj. Lënda ofron mundësi të debatimit të problemeve, të sfidave të

inkluzionit në vende të ndryshme të botës, duke i ndërlidhur me kontekstin kosovar. Ofrohen edhe mundësi të vlerësimit të situatës në institucionet arsimore dhe me gjerë në Kosovë dhe formave të implementimit të edukimit inkluziv. Gjithashtu, zhvillohen shkathtësi të planifikimit të suksesshëm dhe të zbatimit të parimeve, strategjive të edukimit inkluziv, të cilat shpjen në drejtim të krijimit të një klase dhe shkolle inkluzive.

## 7.2 Menaxhimi i klasës

Përmes këtij kursi ofrohen njohuri e shkathtësi, përkitazi me kuptimin e konceptit “menaxhim i klasës”, faktorët e mësimit dhe rëndësinë e tyre, format e krijimit të një mjedisi të përshtatshëm të të nxënit, aspektet e menaxhimit të aktiviteteve mësimore si pjesë e rëndësishme për menaxhimin e klasës, menaxhimin e disiplinës në klasë, trajtimin dhe menaxhimin e sjelljes së papërshtatshme në klasë, përfshirjen aktive të të gjithë nxënësve në klasë pa dallim, trajtimin e suksesshëm të diversiteteve në klasë, etj. Studentët do të kenë mundësinë të analizojnë teori dhe praktika të menaxhimit të suksesshëm të klasës, të shfrytëzojnë me efektivitet aktivitetet dhe kohën e paraparë për orë mësimore, fillimin dhe mbarimin e suksesshëm të mësimit.

## 7.3 Komunikimi në arsim

Kursi *Komunikimi në arsim* ofrohet për të promovuar procesin e komunikimit në arsim, njohjen dhe zbatimin e suksesshëm të tij në praktikën mësimore. Në kurs trajtohen aspektet më të përgjithshme të komunikimit, të modaliteteve, teknikave dhe teknologjisë bashkëkohore për komunikim në veprimtarinë arsimore me qëllim të avancimit të shkathtësive themelore intelektuale në mësim, si të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit aktiv me qëllim të zbatimit të suksesshëm të tyre në praktikë. Në kurs ofrohen përmbajtje për modalitetet dhe kërkesat aktuale për komunikim ndërveprues në mësim, duke iu referuar komunikimit autokasional, koaksional dhe formave të ndryshme të komunikimit në grup për qëllime mësimore. Kursi ofron modalitete të ndryshme të teknologjisë së fjalës së shkruar dhe të fjalës së folur në praktikën arsimore. Veçmas, do të trajtohet aktualiteti dhe zbatimi i modaliteteve të fjalës së folur dhe të fjalës së shkruar, si dhe të modaliteteve të teknologjisë arsimore për komunikim në distancë.

## 7.4 Menaxhimi i arsimit dhe politikat arsimore

Kursi ofron njohuri bazike në fushën e menaxhimit të projekteve zhvillimore në institucione arsimore. Trajtohen tema që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe udhëheqjen në arsim, me mënyrën e hartimit dhe zbatimit të projekteve

zhvillimore, si dhe menaxhimin dhe vlerësimin e politikave arsimore në vend dhe më gjerë.

## 8.1 Sistemi emëror dhe foljor i shqipes

Ky kurs karakterizohet nga prirja për të dhënë sa më pak teori drejtpërdrejt dhe sa më gjerë faktet e strukturat tipike të gjuhës standarde shqipe, në sistemin emëror dhe në sistemin foljor, të karakterizuara dhe të klasifikuara në përputhje me arritjet bashkëkohore në fushën e gjuhësisë. Këtu do të pasqyrohen shumë arritje teorike të pranueshme, por nuk do të mungojnë edhe qëndrimet e reja dhe dukuri të veçanta gjuhësore, për klasifikime kategorish dhe për paraqitjen e tyre. Këtu do të japim strukturën e plotë të sistemit emëror dhe të sistemit foljor, duke i paraqitur në mënyrë sa më të thjeshtë e të kuptueshme që është e mundur dhe duke i ilustruar me shembuj të marrë nga burimet e shkruara të autorëve tanë të njohur.

## 8.2 Gramatikë e zbatuar

Objekt i këtij kursi janë parimet, kriteret dhe metodat e aplikimit të gramatikës në tekstet shkollore. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: fillimet e gjuhësisë së zbatuar, aspekti komunikues i të mësuarit të gjuhës, mësimi i gramatikës së aplikuar në shkollë, zbërthimi i konceptit të gjuhës së aplikuar përmes vizionit kurrikular për mësimin e gjuhës, gjuha e zbatuar dhe mësimi i gjuhës në shkollë, prurjet leksikore përmes teksteve shkollore, konceptet dhe terminologjia e teksteve të gjuhës, gjuha e teksteve të përkthyer, etj. Studentët do të bëhen hulumtues të metodave të aplikimit të gramatikave në tekstet shkollore. Ata do të arrijnë të përmirësojnë parimet themelore të aplikimit të gjuhësisë së zbatuar në tekstet shkollore.

## 9.1 Autorë të zgjedhur të letërsisë

Kursi fokusohet në studimin e autorëve të veçantë të letërsisë shqipe, duke e analizuar problematikën e fenomenit të autorit në letërsi nga pamje të ndryshme. Kështu, brenda këtij kursi do të debatohen çështje esenciale, që kanë të bëjnë me individualitetin dhe konceptin e autorit, trajtën e tij në botën tekstuale, funksionin e tij, duke pasur për bazë dy rryma filozofike, që janë marrë me këtë çështje, atë anglo-saksone dhe tjetrën, bllokun amerikan. Do të ballafaqohen modelet kryesore të këtyre rrymave, në mënyrë që të marrë kahje debati e pastaj të kalohet në sprovimin e teorive me autorët përfaqësues të letërsisë shqipe. Brenda këtij kursi është paraparë që të studiohen nga tre autorë të caktuar, (p.sh. Pjetër Budi, Pjetër Bogdani, Jeronim de Rada, Serembe, Skiroi, Naim Frashëri, Gjergj Fishta, Migjeni, Noli, Lasgushi, Kuteli, Koliqi, Jakov Xoxa, Dritëro Agolli, Ismail Kadare,

Rexhep Qosja, Ali Podrimja, Bilall Xhaferi, Azem Shkreli, etj.), të cilët do të ndërrohen nga viti në vit. Pasi që, bëhet fjalë për vetëm tre autorë dhe është paraparë që të zbatohet edhe metoda krahasimtare, duke vënë në pah pikëtakimet dhe pikëdallimet mes tyre, gjë e cila do të realizohet në punimet me shkrim, të cilat orientimisht do të kenë kahje krahasuese.

## 9.2 Tipologjia e letërsisë shqipe

Ky kurs fokusohet në studimin e tipologjisë së letërsisë shqipe, duke e shikuar nga prizmi i zhanreve letrare, modeleve letrare dhe shkollave letrare, si skema me anë të cilave do të arrihet klasifikimi, shqyrtimi e analizimi i letërsisë shqipe. Do të shihen fenomenet e transformimeve zhanrore të poezisë, prozës, dramës dhe kritikës letrare, gjithnjë duke u mbështetur në strukturat ligjërimore, figurat, modelet shkrimore dhe kodet e diskutet dominante. Kështu, shqyrtimi i veprave fikzionale të autorëve, që me veprat e tyre kanë filluar shkrimin në një formë të caktuar letrare si dhe autorëve pasues, të cilët kanë vënë qartë skemat e kodifikuara zhanrore, do të përcillet edhe me dijen teorike, përmes së cilës do të jetë i mundur identifikimi, qartësimi dhe tipizimi i letërsisë.

## 10 Praktikë e mësimdhënies

Qëllimi parësor i komponentit të mësimi praktik është, që studentëve të masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për dizajnimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe klasës. Komponenti i mësimi praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata, në aktivitete mësimi, ashtu siç edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave. Mësimi praktik përfshin dy komponentë të ndarë, por të lidhur ngushtë:

1) Mësimin praktik në fakultet, i cili ka dy qëllime primare:

- t'u ofrojë studentëve përgatitjen, që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa,
- t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha, që kanë kaluar në klasë.

2) Mësimi praktik në shkolla, i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara, për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë. Kjo përfshin zhvillimin e aftësive: për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies,

për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës. Përderisa mësimi praktik në fakultet realizohet nën mbikëqyrjen e personelit akademik të fakultetit, pjesa e mësimit praktik në shkolla realizohet nën mbikëqyrjen e mësimdhënësve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit.

Mësimi praktik për studentët e këtij programi do të realizohet gjatë muajit shkurt, para fillimit të semestrit të dytë dhe do të zgjasë 2 javë. Gjatë kësaj periudhe do të kombinohet mësimi praktik në fakultet me mësimin praktik në shkolla, duke u bazuar në Doracakun e mësimit praktik. Gjatë mësimit praktik, studentët do të mbajnë shënimet vijuese:

*Portofolion* Një portofolio për planet e njësive mësimore dhe çdo material që përdoret për t'i mbajtur ato njësi. Studentët këtu mund të përfshijnë edhe kopjet e punimeve të nxënësve (si p.sh. ese, detyra, foto, etj.), të cilat kanë rezultuar nga ora mësimore.

*Ditarin e studentit mësimdhënës.* Një ditar të lidhur të shkruarit reflektiv, duke treguar të menduarit e studentit lidhur me atë, që ka mësuar dhe synimet e tij/saj për të nxënit e ardhshëm. Kjo do të përfshijë diskutimin e të nxënit nga përvojat dhe vetëvlerësimi dhe temat, në të cilat studenti ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura.

*Ditarin e mbikëqyrësit.* Secili student do të ofrojë një ditar të lidhur, në të cilin mësimdhënësi mentor dhe mbikëqyrësit e Universitetit shkruajnë të dhënat e vërtetimit dhe shënimet.

Këto dokumente do të jenë bazë për vlerësimin e studentit

## 11. Punimi i tezës

Punimi i tezës së masterit profesional, si fazë përfundimtare e studimeve në nivelin e dytë, u mundëson studentëve të tregojnë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për organizimin dhe përfundimin e një projekti hulumtues. Puna e studentëve me bazë hulumtimin, duhet të demonstrojë kompetenca të nevojshme për përdorimin dhe interpretimin e të dhënave.

Punimi i tezës u kërkon studentëve:

- të planifikojnë, zbatojnë dhe të paraqesin një projekt hulumtues të pavarur,
- të demonstrojnë njohuri dhe të kuptuarit në një disiplinë kryesore,
- të gjermojnë, analizojnë, vlerësojnë, dhe të interpretojnë përmbajtjen nga

literatura relevante e rëndësishme për fushën e tyre të hulumtimit,  
•të përfundojnë projektin hulumtues brenda afatit të përcaktuar kohor.

Teza e masterit është hulumtim i zbatuar dhe i pavarur, i bazuar në studime të mëparshme kërkimore, në të dhënat ekzistuese teorike në fushën e ekspertizës, si dhe në të dhënat empirike të mbledhura në shkolla apo klasa. Teza duhet të synojë në zgjidhjen e një problemi të lidhur me mësimdhënien dhe të nxënit, i identifikuar nga studentit gjatë studimeve dhe punës praktike.

Pas përfundimit me sukses të 50% të obligimeve të parapara me planin dhe programin mësimor, studentët do të paraqesin kërkesën për lejimin e temës së propozuar dhe propozojnë mentorin, që do të udhëheqë punën hulumtuese. Studenti/ja pas kërkesës me shkrim për lejim të punimit të temës së propozuar, duhet me sukses të prezantojë projektpropozimin para mentorit të propozuar. Studenti/ja duhet t'i përmbahet udhëzimeve për punimin e projektit të vet hulumtues në Udhëzuesin për punimin e diplomës në studimet master.

## 4.2. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS (GRUPI B)

Përshkrimi për secilin kurs(grupi B)	
1	<p><b>Mësimdhënia efektive</b></p> <p>Kursi përbëhet nga dy pjesë: pjesa e parë trajton aspektet e të nxënës dhe pjesa e dytë (që për nga vëllimi është më e madhe) trajton aspektet e mësimdhënies. Në këtë mënyrë, ofrohen njohuri të avancuara nga fusha e mësimnxënies dhe mësimdhënies. Në kuadër të këtij kursi ofrohen tema, që trajtojnë çështjet e strategjive të të nxënës, stilet e të nxënës, parimeve të mësimdhënies efektive, mënyrave të aplikimit të metodave efektive të mësimdhënies, e-mësimi (e-learning), taktin pedagogjik, rëndësinë e përgatitjes së mësimdhënësit, karakteristikat e mësimdhënësit efektiv, etj. Kursi ofron mundësi të zhvillimit të shkathtësive për zbatim të suksesshëm të parimeve e strategjive të mësimdhënies, identifikimin e sfidave të mësimdhënies dhe dhënies, zbatimit të tyre për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p>
2	<p><b>Psikologji e zbatuar në mësimdhënie</b></p> <p>Kursi përmban qasjet më të reja nga fusha e psikologjisë së mësimdhënies efektive, përmbajtjet aktuale të psikologjisë kognitive për të nxënës si proces intelektual. Po ashtu, në kurs trajtohen edhe aspektet intrinzike dhe ekstrinzike për motivimin e subjekteve për të nxënë të suksesshëm. Do të trajtohen edhe metodat bashkëkohore psikologjike për punë arsimore me studentë, si metodat për tërheqjen, ruajtjen e vëmendjes dhe nxitjen e studentëve për mësimdhënie efektive dhe për të stimuluar mendimin kritik. Në kurs do të trajtohen edhe përmbajtje për ngritjen e bazës motivacionale, të interesave dhe për formimin e qëndrimeve për të nxënë të suksesshëm, por edhe për mësimdhënie ndërvepruese. Po ashtu, do të trajtohet edhe rëndësia e mjeteve të nxitjes dhe mjeteve të pengimit (humbjes së privilegjeve) për arritjen e rezultateve të dëshiruara në veprimtarinë arsimore.</p>
3	<p><b>Mësimdhënia e avancuar nga gjuha dhe letërsia</b></p> <p>Qëllimi i kursit është përgatitja për aktivitetet profesionale për krijimin e teorisë mësimore-edukative të punës me gjuhën dhe letërsinë në shkollë. Kursi ofron metodologji dhe vetëdijësim liberal mbi mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë. Gjatë kursit do të shqyrtohen çështje të tilla, si: faktorët që ndikojnë në procesin e mësimdhënies, klasifikimin e modeleve për të kuptuar, zhvillimin e shprehive të të menduarit dhe shprehive të shoqërisë së dijes.</p>
4	<p><b>Proza moderne shqipe</b></p>



Kursi ka për objekt studimi veprat në prozë të autorëve të periudhës së letërsisë moderne shqipe (Faik Konica, Ernest Koliqi, Mid'hat Frashëri, Migjeni, Mitrush Kuteli, Sterjo Spasse, Petro Marko), të cilat do të shikohen si stile individuale në raport me poetikën e kësaj periudhe letrare. Këtu do të trajtohen shenjat e modernitetit dhe vetëdija e artikuluar krijuese, që bëri kapërcimin e formës letrare të poezisë në prozë, do të flitet edhe për qarkun e veçantë kulturor e historik në kontekstin kohor. Po ashtu, do të trajtohen risitë letrare si neoromantizmi, simbolizmi, realizmi, neoklasicismi e modernizmi, të cilat zënë vend tek individualitetet artistike letrare të autorëve në shqyrtim. Analizat do të përqendrohen kryesisht në kërkim të ideve e domethënieve letrare, të cilat do të zërthehen pas shqyrtimit të rolit të: ngjarjes, temës, figurës, personazhit.

### **5.1** Komunikimi ndërveprues (gjuhë, letërsi, kulturë, folklor, arte)

Objekt studimi në këtë kurs janë mjetet e komunikimit në gjuhë, letërsi, kulturë, folklor dhe arte. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: mjetet dhe simbolika e komunikimit gjuhësor, letrar dhe artistik, komunikimi dhe informacioni, komunikimi me anë të gjuhës, letërsisë dhe arteve të tjera, gjuha në veprim, semantika e gjuhës, komunikimi me ndërveprim, komunikimi dhe shoqëria, komunikimi dhe interneti, etj. Studentët do të bëhen hulumtues të veçorive semiologjike dhe pragmatike, të performancës, të retorikës së komunikimit ndërpersonal, të konceptit ideologjik të komunikimit, të komunikimit masiv, të komunikimit përmes internetit. Ata do të arrijnë të përmirësojnë praktikatat e komunikimit, duke i dhënë prioritet komunikimit gjuhësor.

### **5.2** Kultura e komunikimit gjuhësor

Kursi nga fusha e kulturës së komunikimit gjuhësor, i mundëson studentit të mësojë të komunikojë drejt e mirë në ligjërimin e lidhur (në gjuhën e folur dhe në atë të shkruar). Në këtë kurs do të trajtohen çështje teorike të përcjella edhe me ushtrime praktike. Temat që do të përfshihen në këtë kurs do të jenë: procesi i komunikimit; mekanizmi i komunikimit, rregullat e komunikimit, si dhe shkrimet funksionale–shkrimet praktike (letra, përmbledhja (shkurtorja), kumtesa për shtyp, relacioni, procesverbali, libreci (broshura), fletëpalosja (deplianti), njoftimet (qarkoret), “Curriculum vitae” (CV-ja); të shkruarit si mjet informacioni, etj., gjithnjë duke pasur parasysh zbatimin e standardit gjuhësor, pavarësisht formës e ligjërimin. Temë trajtimi gjatë ligjëratave të këtij kursi do të jenë edhe mënyrat e të shprehurit gjatë një lajmi, raporti, vështrimi (shënimi), komentit, vlerësimi (recensioni), kronike shoqërore, deklarate (ose demanti), ankete, eseje,

bisede (interviste), polemike, reportazhi etj., (kryesisht përmes shembujve praktikë), lloje që, sado që bashkohen në një fushë sipas veçorive të përbashkëta, dallohen njëri prej tjetrit sipas tipareve dalluese. Për ta përvetësuar në shkallë sa më të mirë këtë kurs, studentët do të zbatojnë shkrimin dhe leximin e punimeve gjatë orëve të mësimit ose dhe përmes detyrave të shtëpisë. Nga ata do të kërkohet të mbajnë një portofolio për punimet e tyre me shkrim, të cilat do t'i bëjnë gjatë kursit. Ligjëratat, seminarët, diskutimet, puna në grupe, hulumtimet, literatura e caktuar, zbatimi i strategjive dhe i teknikave të reja mësimore, do ta ndihmojnë studentin për të fituar njohuri e zotësi më të mira për një mësim më të avancuar në kulturë të komunikimit gjuhësor dhe në atë të standardit gjuhësor.

## **6.1** Teoria e folklorit

Kursi synon paraqitjen e fondit etnokulturor të vlerave artistike e shpirtërore, të normave dhe marrëdhënieve, praktikave, besimeve, dokeve e zakoneve, shenjë e identitetit kombëtar, e aftësisë krijuese, e psikës estetike të shqiptarët, si themel e pikënisje nga mund të shpjegohen disa dukuri e prirje karakteristike për letërsinë e shkruar shqipe.

## **6.2** Përkimet ndërmjet letërsisë gojore dhe asaj të shkruar

Ky kurs fokusohet në studimin e folklorit dhe format e tjera të punës që parasheh plani mësimor i lëndës, Përkimet ndërmjet letërsisë gojore dhe asaj të shkruar. Studentët do të fitojnë njohuri të nevojshme mbi lidhjet dhe ngjashmëritë që shfaqen në fushë të folklorit letrar në mes popujve fqinjë, të rajonit dhe më gjerë, i cili bën pjesë në jetën e gjallë të popullit dhe që është ngushtë i lidhur me zakonet dhe besimet e popullit. Kjo bën që shkenca e folkloristikës të këtë nevojë për disiplinat shkencore ndihmëse si: etnografinë-shkencën mbi mënyrën e jetesës së popullit, muzikologjinë- shkencën mbi kulturën e muzikës, ortografinë- shkencën mbi vallëzimin e popullit dhe dialektologjinë- shkencën mbi të folurit e popullit, si dhe ndikimin e saj në letërsinë e shkruar, etj.

## **7** Metodatat e hulumtimit në edukim

Ky kurs fokusohet në paradigmat, çështjet dhe metodatat e hulumtimeve në edukim. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: përkufizimi i metodave të ndryshme të hulumtimeve, analiza kritike e literaturës, grumbullimi i të dhënave sasiore dhe atyre cilësore nga mjediset e të nxëniet, natyra dhe llojet themelore të hulumtimeve, të lexuarit kritik dhe interpretimi i hulumtimeve. Studentët do të bëhen “lexues kritikë” në mënyrë që të analizojnë hulumtimet

sasiore dhe cilësore në fushën e edukimit dhe të shfrytëzojnë rezultatet kërkimore në realizimin e hulumtimeve të tyre për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të të nxënit.

### 8.1 Praktika bashkëkohore në edukimin inkluziv

Kursi ofron njohuri të avancuara nga fusha e edukimit inkluziv. Në këtë lëndë trajtohen tema, që kanë të bëjnë me përkufizimet bashkëkohore të inkluzionit, të drejtat e njeriut/fëmijës, filozofinë e edukimit inkluziv, format e inkluzionit në vendet evropiane, mundësitë e krijimit të një shkolle dhe shoqërie inkluzive, etj. Kursi ofron mundësi të debatimit të problemeve, të sfidave të inkluzionit në vende të ndryshme të botës, duke i ndërlidhur me kontekstin kosovar. Ofrohen edhe mundësi të vlerësimit të situatës në institucionet arsimore dhe me gjerë në Kosovë dhe formave të implementimit të edukimit inkluziv. Gjithashtu, zhvillohen shkathtësi të planifikimit të suksesshëm dhe të zbatimit të parimeve, strategjive të edukimit inkluziv, të cilat shpjen në drejtim të krijimit të një klase dhe shkolle inkluzive.

### 8.2 Menaxhimi i klasës

Përmes këtij kursi ofrohen njohuri e shkathtësi, përkritazi me kuptimin e konceptit “menaxhim i klasës”, faktorët e mësimi dhe rëndësinë e tyre, format e krijimit të një mjedisi të përshtatshëm të të nxënit, aspektet e menaxhimit të aktiviteteve mësimore si pjesë e rëndësishme për menaxhimin e klasës, menaxhimin e disiplinës në klasë, trajtimin dhe menaxhimin e sjelljes të papërshtatshme në klasë, përfshirjen aktive të të gjithë nxënësve në klasë pa dallim, trajtimin e suksesshëm të diversiteteve në klasë, etj. Studentët do të kenë mundësinë të analizojnë teori dhe praktika të menaxhimit të suksesshëm të klasës, të shfrytëzojnë me efektivitet aktivitetet dhe kohën e paraparë për orë mësimore, fillimin dhe mbarimin e suksesshëm të mësimi.

### 8.3 Komunikimi në arsim

Kursi *Komunikimi në arsim* ofrohet për të promovuar procesin e komunikimit në arsim, njohjen dhe zbatimin e suksesshëm të tij në praktikën mësimore. Në këtë kurs trajtohen aspektet më të përgjithshme të komunikimit, të modaliteteve, teknikave dhe teknologjisë bashkëkohore për komunikim në veprimtarinë arsimore me qëllim të avancimit të shkathtësive themelore intelektuale në mësim, si të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit aktiv me qëllim të zbatimit të suksesshëm të tyre në praktikë. Në këtë kurs ofrohen përmbajtje për modalitetet dhe kërkesat aktuale për komunikim ndërveprues në mësim, duke iu referuar komunikimit autokasional,

koaksional dhe formave të ndryshme të komunikimit në grup për qëllime mësimore. Kursi ofron modalitete të ndryshme të teknologjisë së fjalës së shkruar dhe të fjalës së folur në praktikën arsimore. Veçmas, do të trajtohet aktualiteti dhe zbatimi i modaliteteve të fjalës së folur dhe të fjalës së shkruar, si dhe të modaliteteve të teknologjisë arsimore për komunikim në distancë.

#### **8.4** Menaxhimi i arsimit dhe politikat arsimore

Kursi ofron njohuri bazike në fushën e menaxhimit të projekteve zhvillimore në institucione arsimore. Trajtohen tema, që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe udhëheqjen në arsim, me mënyrën e hartimit dhe zbatimit të projekteve zhvillimore, si dhe menaxhimin dhe vlerësimin e politikave arsimore në vend dhe më gjerë.

#### **9.1** Gramatikë e zbatuar

Objekt i këtij kursi janë parimet, kriteret dhe metodat e aplikimit të gramatikës në tekstet shkollore. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: fillimet e gjuhësisë së zbatuar, aspekti komunikues i të mësuarit të gjuhës, mësimi i gramatikës së aplikuar në shkollë, zberthimi i konceptit të gjuhës së aplikuar përmes vizionit kurrikular për mësimin e gjuhës, gjuha e zbatuar dhe mësimi i gjuhës në shkollë, prurjet leksikore përmes teksteve shkollore, konceptet dhe terminologjia e teksteve të gjuhës, gjuha e teksteve të përkthyer, etj. Studentët do të bëhen hulumtues të metodave të aplikimit të gramatikave në tekstet shkollore. Ata do të arrijnë të përmirësojnë parimet themelore të aplikimit të gjuhësisë së zbatuar në tekstet shkollore.

#### **9.2** Zhvillimi i kurrikulës nga gjuha

Objekt i këtij kursi janë didaktika e gjuhës shqipe, objekti i mësimit të gjuhës shqipe në shkollë, si dhe lidhjet e didaktikës së gjuhës shqipe me shkencat e tjera. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: arritjet e gjuhësisë shqiptare në fushën e mësimit të gjuhës shqipe në shkollë, dokumentacioni shkollor, përgatitja e mësuesit, objektivat dhe parimet, fushat tematike të studimit, karakteristikat e kurrikulës së sotme për mësimin e gjuhës shqipe, korniza kurrikulare, linjat e studimit, struktura sintetike e planit mësimor, linjat dhe nënlinjat e studimit të zberthyer në objektiva sintetike, etj. Ata do të arrijnë të përmirësojnë parimet themelore të aplikimit të vizionit kurrikular për mësimin e gjuhës shqipe.

#### **10.1** Vlerësimi në gjuhë dhe në letërsi shqipe

Objekt i këtij kursi janë konceptet, komponentët, kriteret, metodat dhe teknikat e vlerësimit të nxënësve në lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Temat që përfshihen në këtë kurs janë: koncepti mbi vlerësimin, udhëzimet e portofolios për vlerësimin e nxënësve, hartimi i testeve dhe llojet e pyetjeve, etj. Studentët do të bëhen hulumtues të kriterëve dhe metodave të ndryshme për përgatitjen e testeve, me të cilët bëhet i mundur vlerësimi psikologjik, didaktik dhe kulturor i nxënësve në lëndën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Në këtë rrjedhë ata do të arrijnë të përmirësojnë praktikën e vlerësimit të mësimnxënies në lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe.

## 10.2

### Zhvillimi i kurrikulës nga letërsia

Objekt i këtij kursi janë didaktika e letërsisë shqipe, objekti i mësimin të letërsisë në shkollë, si dhe lidhjet e letërsisë me shkencat e tjera. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: arritjet e mësimin të letërsisë në shkollë, dokumentacioni shkollor, përgatitja e mësuesit, objektivat dhe parimet, fushat tematike të studimit, karakteristikat e kurrikulës së sotme për mësimin e letërsisë shqipe, korniza kurrikulare, linjat e studimit, struktura sintetike e planit mësimor, linjat dhe nënlinjat e studimit, të zbërthyer në objektiva sintetike, etj.

## 11

### Praktikë e mësimdhënies

Qëllimi parësor i komponentit të mësimin praktik është, që studentëve të masterit t'u ofrohen mundësitë për të zhvilluar shkathtësitë për dizajnimin dhe realizimin e mësimdhënies efektive në klasë, përfshirë edhe vlerësimin e nxënësve, dhe t'u ndihmojë atyre që të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe klasës. Komponenti i mësimin praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata, në aktivitete mësimi, ashtu siç edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave. Mësimi praktik përfshin dy komponentë të ndarë, por të lidhur ngushtë:

1) Mësimin praktik në fakultet, i cili ka dy qëllime primare:

- t'u ofrojë studentëve përgatitjen, që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa,
- t'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për reflektim dhe diskutim, për ta mundësuar nxënien nga koha, që kanë kaluar në klasë.

2) Mësimi praktik në shkollë, i cili synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e caktuara, për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës së mesme të ulët dhe/ose të lartë. Kjo përfshin zhvillimin e aftësive: për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies, për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës.

Përderisa mësimi praktik në fakultet realizohet nën mbikëqyrjen e personelit akademik të fakultetit, pjesa e mësimit praktik në shkollë realizohet nën mbikëqyrjen e mësimdhënësve mentorë të certifikuar nga Fakulteti i Edukimit.

Mësimi praktik për studentët e këtij programi do të realizohet gjatë muajit shkurt, para fillimit të semestrit të dytë dhe do të zgjasë 2 javë. Gjatë kësaj periudhe do të kombinohet mësimi praktik në fakultet me mësimin praktik në shkollë, duke u bazuar në Doracakun e mësimit praktik. Gjatë mësimit praktik, studentët do të mbajnë shënimet vijuese:

*Portofolion* Një portofolio për planet e njësive mësimore dhe çdo material që përdoret për t'i mbajtur ato njësi. Studentët këtu mund të përfshijnë edhe kopjet e punimeve të nxënësve (si p.sh. ese, detyra, foto, etj.), të cilat kanë rezultuar nga ora mësimore.

*Ditarin e studentit mësimdhënës.* Një ditar të lidhur të të shkruarit reflektiv, duke treguar të menduarit e studentit lidhur me atë, që ka mësuar dhe synimet e tij/saj për të nxënësit e ardhshëm. Kjo do të përfshijë diskutimin e të nxënësit nga përvojat dhe vetëvlerësimi dhe temat, në të cilat studenti ka punuar për t'u përmirësuar, si dhe përshkrimin e përmirësimeve të arritura.

*Ditarin e mbikëqyrësit.* Secili student do të ofrojë një ditar të lidhur, në të cilin mësimdhënësi mentor dhe mbikëqyrësit e Universitetit shkruajnë të dhënat e vërtetimit dhe shënimet.

Këto dokumente do të jenë bazë për vlerësimin e studentit

12

Punimi i tezës

Punimi i tezës së masterit profesional, si fazë përfundimtare e studimeve në nivelin e dytë, u mundëson studentëve të tregojnë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për organizimin dhe përfundimin e një projekti hulumtues. Puna e studentëve me bazë hulumtimin, duhet të demonstrojë kompetenca të nevojshme për përdorimin dhe interpretimin e të dhënave.

Punimi i tezës u kërkon studentëve:

- të planifikojnë, zbatojnë dhe të paraqesin një projekt hulumtues të pavarur,
- të demonstrojnë njohuri dhe të kuptuarit në një disiplinë kryesore,
- të gjerim, analizojnë, vlerësojnë, dhe të interpretojnë përmbajtjen nga literatura relevante e rëndësishme për fushën e tyre të hulumtimit,

- të përfundojnë projektin hulumtues brenda afatit të përcaktuar kohor.

Teza e masterit është hulumtim i zbatuar dhe i pavarur, i bazuar në studime të mëparshme kërkimore, në të dhënat ekzistuese teorike në fushën e ekspertizës, si dhe në të dhënat empirike të mbledhura në shkolla apo klasa. Teza duhet të synojë në zgjidhjen e një problemi të lidhur me mësimdhënien dhe të nxënit, i identifikuar nga studenti gjatë studimeve dhe punës praktike.

Pas përfundimit me sukses të 50% të obligimeve të parapara me planin dhe programin mësimor, studentët do të paraqesin kërkesën për lejimin e temës së propozuar dhe propozojnë mentorin, që do të udhëheqë punën hulumtuese. Studenti/ja pas kërkesës me shkrim për lejim të punimit të temës së propozuar, duhet me sukses të prezantojë projektpropozimin para mentorit të propozuar. Studenti/ja duhet t'i përmbahet udhëzimeve për punimin e projektit të vet hulumtues në Udhëzuesin për punimin e diplomës në studimet master.